



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06  
**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,  
Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 12 tetor 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Viktimave**  
Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**  
Gregori Kihou

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**  
Dejvid Jang

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagenda

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në bazë të nenit 39(13) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe neneve 36(1) dhe 44 të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Udhëzuesi i Punës”),<sup>2</sup> nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIME

1. Më 20 maj 2022, gjatë konferencës së dymbëdhjetë mbi ecurinë e çështjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi ekipet e Mbrojtjes që t’i dorëzonin dosjet e tyre paraprake deri më 21 tetor 2022.<sup>3</sup>

2. Më 10 tetor 2022, ekipet e Mbrojtjes të z. Kadri Veseli, Hashim Thaçi, dhe Jakup Krasniqi (“Mbrojtja”) kërkuan nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të autorizonte shtimin e numrit të lejuar të fjalëve nga 20.000 në 25.000 fjalë për secilën nga dosjet paraprake përkatëse të Mbrojtjes (“Kërkesa”).<sup>4</sup> Mbrojtja parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për shtimin e kërkuar me 5.000 fjalë për shkak të (i) gjatësisë së dosjes paraprake të ZPS-së; (ii) pretendimeve të shumta të cilave duhet t’u përgjigjet Mbrojtja; dhe (iii) elementeve juridike materiale që duhen trajtuar.<sup>5</sup> Gjithashtu, Mbrojtja shton se Kërkesa është dorëzuar në kohë dhe se nuk parashikohet të shkaktojë ndonjë dëm.<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BD-15, Udhëzues i Punës të Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019, publik.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 20 maj 2022, f. 1324, rreshtat 1-6.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, F01024, Mbrojtja e Specializuar, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve*, 10 tetor 2022, publike, para. 2.

<sup>5</sup> Kërkesa, para. 3.

<sup>6</sup> Kërkesa, para. 4-5.

3. Më 11 tetor 2022, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") bëri me dije se nuk e kundërshtonte Kërkesën.<sup>7</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Sipas nenit 44 të Udhëzuesit të Punës, dosja paraprake e dorëzuar në bazë të rregullës 95(5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës nuk duhet të jetë më shumë se 20,000 fjalë.

5. Në përputhje me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës, një pjesëmarrës mund t'i kërkojë leje panelit mjaftueshmërisht në kohë për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve, në rast se provojnë se ekzistojnë arsye të vlefshme të cilat përbëjnë rrethana të veçanta.

## III. DISKUTIM

6. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Kërkesa është dorëzuar në kohë të mjaftueshme përpara afatit për dorëzimin e dosjeve paraprake të Mbrojtjes.

7. Sa u takon arsyeve të vlefshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh arsyet që ka paraqitur Mbrojtja, veçanërisht pretendimet e shumta të cilave Mbrojtja duhet t'u përgjigjet, faktin që ZPS-së iu miratua shtimi i numrit të fjalëve për dosjen e vet paraprake,<sup>8</sup> si dhe që ZPS-ja nuk e kundërshton Kërkesën.

8. Gjithashtu, duke mbajtur parasysh se shtimi i numrit të lejuar të fjalëve do të mundësojë parashtrim më të qartë e më të plotë të dosjes paraprake, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se miratimi i shtimit të numrit të lejuar të fjalëve nuk i shkakton asnjë dëm palës kundërshtare ose Mbrojtësit të Viktimave.

---

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-06, F01025, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve*, 11 tetor 2022, publike, para. 1.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-06, F00600, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve*, 10 tetor 2022, publik, para. 2.

9. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë dhënë arsye të vlefshme që përligjin shtimin e numrit të lejuar të fjalëve dhe e shton në 25.000 fjalë numrin e lejuar të fjalëve për secilën dosje paraprake të Mbrojtjes. Po ashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e çmon të nevojshme t'i miratojë të njëjtin shtim – pra 5.000 fjalë shtesë – Mbrojtjes së Rexhep Selimit për dosjen e vet paraprake.

#### IV. VENDIM

10. Për arsyet e lartcekura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **MIRATON** Kërkesën dhe shton numrin e lejuar të fjalëve për secilën dosje paraprake të Mbrojtjes në 25.000 fjalë; dhe
- (b) **VENDOS** që nga i njëjti shtim me 5.000 fjalë të përfitojë edhe Mbrojtja e Rexhep Selimit për dosjen e vet paraprake.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatësi i Procedurës Paraprake**

E mërkurë, 12 tetor 2022

Hagë, Holandë.